



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

Himarë , më 29.01.2025

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 16.01.2025.

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 16.01.2025 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1. Cilët ishin aktivitetet kryesore festive të organizuara nga Bashkia Himarë gjatë fundvitit (p.sh., evente, koncerte, apo aktivitete kulturore)?
2. A u përfshinë artistë lokalë, kombëtarë apo ndërkombëtarë në këto aktivitete? Nëse po, cilët ishin ata?
3. A u organizuan aktivitete të veçanta për fëmijë, të moshuar apo grupe të tjera të komunitetit?
4. Sa ishte pjesëmarrja e komunitetit lokal në këto aktivitete?
5. A pati bashkëpunime me institucione, shoqata, apo organizata të tjera për realizimin e këtyre aktiviteteve?
6. Sa ishte kostoja totale për organizimin e këtyre aktiviteteve festive? Ju lutem, nëse është e mundur, përfshini edhe ndarjen e shpenzimeve kryesore (p.sh., për koncerte, organizim, artistë, etj.).

Aktivitetet e fundvitit, Himarë 2024

Në kuadër të festimeve të fundvitit, gjatë muajit dhjetor, Bashkia Himarë organizoi një sërë aktivitete festive për të krijuar një atmosferë gëzimi dhe për të bashkuar komunitetin. Këto aktivitete synonin të ofronin argëtim, ndërveprim social-kulturor dhe një frymë festive për të gjithë.

Qëllimet kryesore të aktiviteteve ishin:

Promovimi i Himarës si një destinacion turistik gjatë gjithë vitit, jo vetëm në verë.

Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore në komunitet.

Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe argëtuese për fëmijët.

Aktivitetet kryesore festive:

🎬 Shfaqje filmash për fëmijë

Një program i dedikuar për fëmijët, ku ata patën mundësinë të shijonin filma vizatimorë të përzgjedhur. Aktiviteti u zhvillua për katër ditë rresht në sallën "Neço Muko" pranë Bashkisë Himarë, me dy filma në ditë – filma vizatimorë në mëngjes dhe filma për grupmoshën 10+ pasdite.

🎭 Shfaqja teatrale "Gruaja e Burrit Tim"

Një eksperiencë unike kulturore për publikun himariot, me regji të Kiço Londos. Shfaqja solli një atmosferë të veçantë për artdashësit e qytetit.

🎵 Koncert festiv me këngë dhe valle nga fëmijët e shkollës 9-vjeçare

Nxënësit e kopshtit dhe shkollës 9-vjeçare "Pano Meniko" performuan me këngë, valle dhe recitime në sallën "Neço Muko", duke krijuar një atmosferë të ngrohtë festive për prindërit dhe komunitetin.

🎄 Christmas PotFest Himara

Një festival që promovoi trashëgiminë kulturore shqiptare dhe Himarën si destinacion turistik. Eventu solli:

Ekspozita artizanale me produkte "Made in Albania".

Prezantim të vlerave tradicionale në artizanat, tekstile, qëndisje, pirografi dhe kostume popullore.

Shfaqje me këngë dhe valle nga grupet polifonike të Himarës dhe Pilurit, si dhe artistë të njohur kombëtarë.

Shpërndarje dhuratash për fëmijët nga Babagjyshi i Vitit të Ri.

✦✦ **Eventi i ndezjes së dritave për Vitin e Ri**

Një aktivitet simbolik ku fëmijët e shkollës 9-vjeçare përgatitën një program me recitime dhe kërcime. Kryetari i Bashkisë ndezi dritat festive të qytetit, ndërsa atmosfera u mbush me muzikë dhe performanca nga DJ.

🌸 **Fishekzjarret e ndërrimit të viteve**

Himara u zbulua me një spektakël madhështor fishekzjarresh, duke ndriçuar qiellin e qytetit në natën e ndërrimit të viteve.

Pjesëmarrja dhe ndikimi në komunitet

Festimet përfshinë artistë lokalë dhe kombëtarë, duke krijuar një program të larmishëm për të gjithë komunitetin. Shfaqjet dhe koncertet ishin të hapura për të gjithë, duke ofruar mundësi për të shijuar artin dhe kulturën. Përveç të rriturve, edhe fëmijët ishin në qendër të vëmendjes me aktivitete të dedikuara për ta.

Këto evente festive forcuan identitetin kulturor të Himarës dhe krijuan një hapësirë për bashkëpunim, gëzim dhe shpresë për vitin e ri.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!